# DËSHMI ARKIVI

**A-444404**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Erion Veliaj do të dalë nesër nga burgu? Plarent Ndreca në Top Story: Nesër presim lirimin e tij, ja pse |
| ADRESA | `https://newsbomb.al/politike/erion-veliaj-do-te-dale-neser-nga-burgu-plarent-ndreca-ne-top-story-nes-i401210` |
| BURIMI | newsbomb.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 19:45:47 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 19:24:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d3c3c9dec6963c90069ee26e1032aa901b6f0aa604d002bb3f64f21e967dca7c` |
| TEKSTI | `068209d92f9679111fb4380cc36573771e79c283edf6683f008d8d0fce96bf91` |
| PAMJA | `b18e800b9781dbdbf9d419818c2b026e2adf9e301b393669ed25996eac7e11d7` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e91726b433df331a2eafe968fa4a85950e774ad01a83baba814dd278195df64c` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `49912a82e108233a2f4c1eb29c0feee4310e444550233db1ec41850f1c69f554` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e91726b433df331a2eafe968fa4a85950e774ad01a83baba814dd278195df64c`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Hapësire reklamuese



Politikë

14 Shtator 2026, 21:24

# Erion Veliaj do të dalë nesër nga burgu? Plarent Ndreca në Top Story: Nesër presim lirimin e tij, ja pse

Shkruar nga **Newsbomb**



**Foto akriv: Erion Veliaj dhe Plarent Ndreca**

Në "vigjilje" të ditës kur dhe pritet të vendoset fati i kryebashkiakut të arrestuar, Erion Veliajt, në studion e emisionit "Top Story" është diskutuar lidhur me Tiranën e cila është pa kryetar dhe çfarë pritet të ndodhë me të.

Pjesë e panelit ka qenë edhe avokati i kryebashkiakut, ish-deputeti Plarent Ndreca, i cili gjatë fjalës së tij u shpreh se ditën e nesërme presin lirtimin e tij, teksa argumentoi më tej edhe pikat e Kushtetueses të cilat e thonë qartë e bardha mbi të zezë se një i zgjedhur nga populli nuk mund të qëndrojë në qeli pa pasur prova të besueshme të cilat e inkriminojnë atë.

Sipas Ndrecës, kjo balancë nuk është vetëm një çështje që buron nga jurisprudenca shqiptare, por është një parim i trajtuar edhe nga Komisioni i Venecias. Ai ka argumentuar se për sa kohë bëhet fjalë për një funksionar të zgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët, vendimmarrja për masën e sigurisë duhet të jetë e argumentuar dhe në balancë.

*"Gjykata ka detyrim që të marrë në shqyrtim jo vetëm një interes, por çdo interes Kushtetues dhe drejtimi i Bashkisë së Tiranës është një e drejtë Kushtetuese. Gjykata, ashtu siç e thotë Kushtetuesja tanimë, që në shqyrtimin që ju do i bëni masës së sigurimit, përveç elementeve, kushteve, si çdo individ, ju do të vendosni në balancë dhe të drejtën që ka kryetari i Bashkisë dhe qytetarët e Tiranës që të drejtohen nga ai që kanë zgjedhur. E thotë edhe Komisioni i Venecias, jo vetëm Gjykata Kushtetuese.*

Revista




Abonohu tani dhe lexoje

## Lajmet e fundit



**Rajoni**
Ushtruan dhunë brutale ndaj një indiani, arrestohen dy shtetas shqiptarë në Greqi



**Aktualitet**
"Armët mes tyre janë ulur", gazetari Muça: Veliaj është i zgjedhur i Tiranës, Rama nuk mund ta shkarkojë si ministrat

Zbulo më shumë artikuj

Gjykatat, kur bëhet fjalë për një kryetar Bashkie, një të zgjedhur, duhet të kenë kujdes sepse duhet të ruajnë balancën"*, tha ai.

Në të njëjtën linjë, avokati ka kundërshtuar edhe argumentin se Veliaj mund të ndikojë apo të intimidojë personat nën hetim duke thënë se nuk ekziston asnjë provë konkrete që të mbështesë një dyshim të tillë

*"Nuk ka asnjë provë, dyshim të bazuar që Veliaj ka intimiduar apo mund të intimidojë. Këto nuk janë hipotetike, por e thotë dhe Kushtetuesja në shpjegimin e saj. Një anëtar i Gjykatës Kushtetuese thotë që jo vetëm nuk plotëson kriteret, por nuk ka dyshime të arsyeshme fare. Nuk ka prova fare për zotin Veliaj, janë të gjitha aludime, hipotetike. Po flas për çfarë ka mbledhur SPAK deri tani. Aman sot, një anëtar i Kushtetueses ka folur për themelin sepse ka parë qartësisht që nuk ka dyshim të arsyeshëm që është kusht për të marrë masë sigurimi, jo arrest me burg, arrest me burg është masa më ekstreme. Që të marrësh një masë sigurimi për një person në hetim duhet të plotësohet kushti për kushtin e dyshimit të arsyeshëm, një anëtar i Kushtetueses thotë që nuk ka prova fare për intimidim"*, tha ai më tej.

Pas tij fjalën e ka marrë gazetari Filip Çakulli, i cili ka mbajtur një qëndrim të ngjashëm, duke argumentuar se bazuar në ato që janë bërë publike deri më tani, nuk janë paraqitur prova të mjaftueshme që të justifikojnë arrestimin dhe mbajtjen në burg të Veliajt.

*"Për Veliaj nuk janë mbledhur provat e duhura për ta arrestuar dhe për ta futur në burg. Janë mbledhur thashetheme dhe një pjesë e prokurorëve kanë nxjerrë vetë në mënyrë të paligjshme telefonata. Tani prokuroria thotë që populli e di që ai është fajtor. Përderisa bëhet ky linçim publik…"*, tha ai ndër të tjera.

Diskutimi vjen në një moment vendimtar për fatin e Erion Veliajt, teksa Gjykata e Lartë pritet të japë nesër më 15 shtator një vendim që mund të përcaktojë jo vetëm vijimin e masës së arrestit, por edhe mënyrën se si do të funksionojë Bashkia e Tiranës në vijim.

## Sondazh

Poll

### Lexo gjithashtu




E Hënë 20:14

## "Të q**** r*** o Edi Rama", incident në avionin ku po udhëtonte kryeministri, momenti kur ai dorëzon në duart e karabinierëve shqiptarin që e shau (VIDEO)









Politikë

Edi Rama reagon sërish për rrogat e gjyqtarëve, tregon "vendin" e Kushtetueses: Vetëm qeveria ka të drejtë për pagat

E Hënë 19:25

Politikë

Begaj vizitë në Emiratet e Bashkuara Arabe, pritet nga zyrtarët e lartë! Ja çfarë u diskutua në takime

E Hënë 17:52




E Hënë 17:38

## Mandi Jatagani alarmoi Policinë se në shkollën "Emin Duraku" kishte bombë, Koçiu i nxjerr foton nga protesta: Çmenduri e mirëfilltë kriminale






Politikë

Ish-deputeti shkon i alarmuar në Komisariatet e Tiranës: Policia më ka marrë djalin sot në protestë, kam telefonuar 112, nuk po e gjejmë

E Hënë 14:34

Politikë

Deklaratat kundër kryedemokratit, dhëndri i Berishës sulmon Enkelejd Alibeajn: Qen nga rruga...

E Hënë 14:01




E Hënë 13:25

## “Shkallë rrëqethëse padituri!” Rama u përgjigjet sërish gjyqtarëve: S’mund të merrni paratë nga thesari i shtetit se i “keni mbledhur vetë”, ç'mbetet për të tjerët pastaj?



Politikë

Erion Veliaj nesër në Gjykatën e Lartë, kryetarët e bashkive ballkanike deklaratë të përbashkët: Shpresojmë se vlerësimi do të jetë i drejtë! (E PLOTË)

E Hënë 13:13



Politikë

Berisha u prit me këngë e valle në Rinas pas vizitës në SHBA, ironia e Mustafa Nanos: Arsyeja pse shqiptarët nuk votojnë PD-në

E Hënë 12:52




E Hënë 11:39

## Niko Peleshi pret të ngarkuarën me punë të SHBA-së Nancy VanHorn në kryesinë e Kuvendit



Politikë

Sali Berisha uron për fillimin e viti të ri shkollor, por nuk kursen kritikat për qeverinë: Nisim me 5900 nxënës më pak

E Hënë 10:22



Politikë

Engert Pëllumbi i GJKKO-së tha se s’po u lejohet të marrin nga qesja e tyre, reagon Edi Rama: E pabesueshme që e shikon kështu buxhetin e shtetit

E Diel 19:31






Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.